



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 70/12 prot.

Datë 06.02.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 149 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 98/2024, datë 26.01.2024, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN*”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.  
*Adresa: Rruga “Maliq Muco” nr.19, Tiranë*

**Ankimues:** Operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK, me Nipt. K11507003S, *Adresa: Rruga: “Bardhok Biba”, Pallati Trema, Hyrja C, Tiranë.*

Operatori ekonomik “NELSA” SHPK, me Nipt. J71601012S. *Adresa: Rr: Tiranë - Dajt, Lagjja “Qesarakë”, Nr. Pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit*

*të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 26.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 98/2024, ku vendosi:

**Vendos:**

- 1. Të mbyllë çështjen lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.*
- 2. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.*
- 3. Autoriteti kontraktor të anulohet procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 4. Autoriteti kontraktor përpara publikimit të procedurës së prokurimit të sjellë pranë KPP-së kopje të DST.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NELSA” SHPK.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK.*
- 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.11 prot., date 01.02.2024, protokolluar me tonën nr. 70/9 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 98/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

**II**

**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.11 prot., date 01.02.2024, protokolluar me tonën nr. 70/9 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor *Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë*, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 98/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN*”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë

Komisionit të Prokurimit Publik nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatoi se, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit me datë 09.01.2024 gjithashtu referuar shkresës së mësipërme, autoriteti kontraktor ka përcjellë DST e re të hartuar me modifikime bazuar në vendimin e KPP-së.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë ka zbatuar vendimin Nr. 98/2024, datë 26.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCËN*”, me fond limit 2.791.328 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

